

## **LIGJ**

**Nr. 111/2015**

### **PËR SHËRBIMIN GJEOLGJIK SHQIPTAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

#### **KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**KREU I**

**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

#### **Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim të përcaktojë parimet e organizimit, drejtimit, bazat dhe detyrat e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar.

Neni 2

#### **Objekti**

Ky ligj rregullon marrëdhëniet ndërmjet Shërbimit Gjeologjik Shqiptar dhe sektorëve publik e privat, për nxitjen e shfrytëzimit të resurseve minerare në përfitim maksimal të publikut.

Neni 3

#### **Përkufizime**

Në këtë ligj me termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Ministria” është ministria përgjegjëse për veprimtarinë e shërbimit gjeologjik.
2. “Ministër” është ministri përgjegjës për shërbimin gjeologjik.
3. “Mineral” është çdo substancë në gjendje të ngurtë, të lëngët e të gaztë, që ndodhet në trajtë natyrore mbi ose nën tokë, në ose nën ujë, formuar prej proceseve gjeologjike.
4. “Mineral i dobishëm” është çdo substancë në gjendje të ngurtë, të lëngët e të gaztë, që ndodhet në trajtë natyrore mbi ose nën tokë, në ose nën ujë, formuar prej proceseve gjeologjike, që

plotëson kushtet gjeologjike, minerare dhe teknologjike për përdorim në degë të ndryshme të ekonomisë.

5. “Ujëra nëntokësore” janë të gjitha ujërat e zonës së ngopjes, që formojnë shtresa, me dhe pa trysni.

6. “Basen ujqor” ka kuptimin që jepet në ligjin “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”.

7. “Shkenca të tokës” janë disiplinat kryesore, si: gjeologjia, metalogjia, gjeokimia, gjeofizika, hidrogeologjia, gjeologjia inxhinierike, gjeomjedisi, mineralogjia, petrografia, petrologjia, paleontologjia, stratigrafia, topografia dhe pedologjia.

8. “Kërkim-zbulim” janë fazat metodike të kryerjes së vrojtimeve, studimeve, vlerësimeve, punimeve gjeologjike komplekse, me qëllim identifikimin e ekzistencës së mineraleve të dobishme.

9. “Vlerësim” është përcaktimi cilësor e sasior i mineralit, në përputhje me kërkesat teknikoekonomike të çdo stadi studimor.

10. “Agrogeologji” është studimi kompleks i tokës për përdorimin efektiv dhe mbrojtjen e saj.

11. “Autoritet shkencor” është një person me gradë ose titull shkencor.

## KREU II

### OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHËRBIMIT GJEOLGJIK SHQIPTAR

#### Neni 4

#### **Shërbimi Gjeologjik Shqiptar**

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar është institucion këshillimor, teknik dhe shkencor i shtetit, person juridik publik, buxhetor, i cili kryen veprimtari në fushën e shkencave të tokës në territorin e Republikës së Shqipërisë.

#### Neni 5

#### **Organizimi**

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar organizohet si Drejtori e Përgjithshme, në varësi të ministrit dhe e ka selinë e tij në Tiranë.

#### Neni 6

#### **Veprimtaria**

Në veprimtarinë e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar përfshihen:

- a) studimet gjeologjike sistematike bazë në tokë, në dete, në liqene dhe lumenj, në territorin e Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet hartografimeve komplekse të shkallëve të ndryshme për administrimin e territorit e të mineraleve;
- b) studimet e thelluara shkencore për gjeologjinë dhe metalogjeninë;
- c) studimet gjeofizike e gjeokimike të çdo shkalle;
- ç) studime dhe promovime të perspektivës së mineraleve të dobishme;
- d) studimet hidrogeologjike të baseneve ujore, monitorimi i tyre dhe përcaktimi i masave për ruajtjen e rezervave ujore nëntokësore;
- dh) studimet gjeologjike komplekse për mjedisin dhe monitorimin e tij, në funksion të planifikimit e të administrimit të territorit;
- e) studime gjeologo-inxhinierike dhe rreziqet gjeologjike;
- ë) studime agrogeologjike dhe studime për erozionin;
- f) studime, vlerësime dhe monitorime të gjeomonumenteve;
- g) kërkime dhe vlerësime të mineraleve metalore, hidrokarbureve, mineraleve industriale, burimeve ujore nëntokësore, ujërave të pijshme e industriale, ujërave minerale e termale;
- gj) vlerësimi, mbikëqyrja dhe monitorimi i lejeve minerare të kërkim-zbulimit;
- h) matjet topo-gjeodezike;
- i) krijimi i bazës së të dhënave gjeologjike, bilanceve të rezervave të mineraleve të dobishme, rezervave të ujërave nëntokësore, rreziqeve gjeologjike dhe vënia në dispozicion e tyre organeve të pushtetit qendror e vendor, subjekteve të tjera të interesuara, përgatitja dhe publikimi i informacionit.

## Neni 7

### **Marrja e të dhënave dhe informacioneve**

1. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar ka të drejtë dhe detyrë të grumbullojë dhe të ruajë në Arkivin Qendror Teknik të Gjeologjisë të gjithë informacionin e dokumentacionin e përfituar deri tani dhe atë që do të përfitohet në të ardhmen në fushën e gjeologjisë bazë, të mineralogjisë, të gjeofizikës, gjeokimisë, stratigrafisë, hidrogeologjisë, gjeologjisë inxhinierike, topogjeodezisë, kampionaturën, provat e dublikatet e tyre, të sistemojve, të ruajë, të përpunojë e të informatizojë këto informacione dhe t'i përdorë sipas rregullave që përcaktohen në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

2. Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore është e detyruar të dorëzojë në Arkivin Qendror Teknik të Gjeologjisë, për qëllime studimore, raportet e studimeve të çdo lejeje hidrokarbure kërkim-zbulimi.

3. Në Arkivin Qendror Teknik të Gjeologjisë arkivohet informacioni gjeologjik i çdo zotëruesi të lejes minerare e të lejeve të kërkim-zbulimit, duke respektuar kërkesat e ligjit minerar.

4. Pranë Shërbimit Gjeologjik Shqiptar arkivohet edhe dokumentacioni gjeologjik krahinor i studimeve dhe lejeve, si dhe dokumentacioni faktik i punimeve gjeologjike, hidrogeologjike, gjeologo-inxhinierike e inxhinierike të çdo natyre të gërmimit të tokës, të kryera nga subjekte private apo shtetërore në fazën e zbatimit të projektit dhe raportit përfundimtar.

Neni 8

### **Aksesi ndaj projekteve hidrogeologjike**

1. Personi, fizik ose juridik, privat ose shtetëror, që kryen shpime për ujërat nëntokësore, me thellësi mbi 15 m nga sipërfaqja e tokës, përpara se të paraqesë projektin hidrogeologjik në këshillin e baseneve, është i detyruar të marrë miratimin për projektin nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, që e shqyrton sipas akteve ligjore përkatëse.

2. Pas miratimit të lejes, një kopje e projektit dhe një kopje e relacionit për rezultatet e punimeve të kryera depozitohen në Arkivin Qendror Teknik të Gjeologjisë.

Neni 9

### **Kryerja e shërbimeve për të tretët**

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar kryen shërbime me pagesë për të tretët, sipas parashikimeve të nenit 6 të këtij ligji. Për studime dhe projekte që kryhen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë merret miratimi i ministrit.

KREU III

ORGANIZIMI

Neni 10

### **Drejtimi**

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe, në mungesë të tij, nga Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm.

Neni 11

**Këshilli teknik**

1. Brenda strukturës së Shërbimit Gjeologjik Shqiptar funksionon Këshilli Teknik Shkencor.
2. Këshilli Teknik Shkencor bën diskutimin dhe miratimin e programeve të zhvillimit, projekteve dhe raporteve studimore të ndryshme.
3. Përbërja e Këshillit Teknik Shkencor dhe rregullorja e funksionimit të tij miratohen nga ministri, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm.

Neni 12

### **Marrëdhëniet e punës**

1. Marrëdhëniet e punës së Drejtorit të Përgjithshëm dhe nëpunësve të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar rregullohen në bazë të legjislacionit për nëpunësin civil.
2. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar duhet të jetë person me autoritet shkencor dhe me përvojë pune në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar ose struktura të tjera të këtij lloji.

Neni 13

### **Kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm**

Drejtori i Përgjithshëm ka këto kompetenca:

- a) drejton dhe menaxhon veprimtarinë e institucionit;
- b) përfaqëson Shërbimin Gjeologjik Shqiptar në marrëdhëniet me të tretët;
- c) administron buxhetin e miratuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe përgatit projektbuxhetin për vitin e ardhshëm;
- ç) nxjerr urdhra dhe udhëzime për veprimtarinë e strukturave të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar;
- d) i propozon për miratim ministrit rregulloret dhe aktet në zbatim të këtij ligji.

Neni 14

### **Funksionimi i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar**

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar funksionon me një rregullore të veçantë, e cila miratohet nga ministri.

KREU IV

### **MËNYRA DHE BURIMET E FINANCIMIT**

Neni 15

## **Financimi**

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar financohet nga Buxheti vjetor i Shtetit dhe nga të ardhurat e shërbimeve me të tretët.

Neni 16

### **Tarifat e shërbimeve**

1. Tarifat e shërbimit me pagesë për të tretët, që kryhen nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, miratohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe ministrit.
2. Të ardhurat e krijuara nga shërbimet me të tretët përdoren nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 17

### **Pjesëmarrja në projekte**

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar paraqet dhe merr miratim nga ministri për pjesëmarrjen në projektet dypalëshe ose shumëpalëshe, brenda dhe jashtë shtetit.

Neni 18

### **Aktet nënligjore**

Ngarkohet ministri që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore, sipas neneve 11, 14 dhe 16 të këtij ligji.

Neni 19

### **Shfuqizime**

Ligji nr. 8366, datë 2.7.1998, “Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar”, të ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 20

### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 15.10.2015 Shpallur me dekretin nr. 9287, datë 23.10.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani